

Tiranë, më __. __. 2019

MBLEDHJA E KËSHILLIT TË GJYKATËS

Datë 12.07.2019

I mbajtur sot me date **12.07.2019** në Gjykatën Administrative të Apelit

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Çelet mbledhje e Këshillit të Gjykatës e planifikuar nga mbledhja e mëparshme, e cila nuk u zhvillua për shkak të mungesës të Kancelarit.

Të pranishëm në mbledhje janë: Zëvendëskryetarja e gjykatës dhe Kancelari i gjykatës.

Këshilli është i formuar siç është pasqyrur dhe në mbledhjen e mëparshme konform kërkesave të ligjit dhe nga ky moment do të ushtrojë funksionet referuar përcaktimeve të ligjit dhe vendimit nr. 71 datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Jeni njoftuar për rendin e ditës, jeni njoftuar për tre pikat e rendit të ditës konkretisht:

1. Miratimin e kalendarit të mbledhjeve të Këshillit të Gjykatës
2. Projekt buxheti 2020-2022
3. Disiplina në punë.

Pika e projekt buxhetit 2020-2022 në fakt është përfshirë për shkak të faktit që duhet mbajtur ky qëndrim projekt buxheti të bërë me propozimet respektive.

Thirret K/Deges së Buxhetit nëse do të ketë pyetje.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës pyet: Për kalendarin e punimeve, keni ndonjë ide?

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Është detyrim që të paktën minimalisht të ketë një mbledhje në muaj. Megjithatë duke qënë se ky organ në këtë menyrë se si është konceptuar është i ri pavarësisht se aktorët janë pjesë e gjykatës ne mund të planifikojmë sipas vlerësimeve ku janë të mirëpritura edhe mendimet te anëtarëve të Këshillit që të bëhet mbledhje kur të çmohet e nevojshme për çështje duke respektuar edhe afatin e njoftimit dhe çështjet që do diskutohen.

Në parim është përcaktuar që mbledhjet do të jenë: Në datë 26 Korrik 2019, 27 Shtator 2019, 25 Tetor 2019, 22 Nëntor 2019 dhe 18 Dhjetor 2019

Nëse keni ndonjë gjë për të diskutuar, keni ndonjë qëndrim për të mbajtur! Në fakt Shtator do të ishte mire që të mblidhem në një datë në fillim shtatori, por gjithësesi këto do të jenë datat.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës pyet: Jeni dakort me kalendarin?

Zëvendeskryetarja: Dakort

Kancelari i Gjykatës: Dakort

Vendim: Këshilli i Gjykatës vendosi në unanimitet të miratojë kalendarin e mbledhjeve të Këshillit të Gjykatës respektivisht datat: 26 Korrik, 27 Shtator, 25 Tetor, 22 Nëntor dhe 18 Dhjetor 2019, në orën 09:00.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Kalojmë tek pjesa e projekt buxhetit,

Thirret K/Degës Financës

Paraqitet K/Degës së Financës znj.Mimoza Dedja

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Mund të bëni një përmbledhje çfarë është parashikuar për këtë propozim në kuadër të projekt buxhetit.

K/Degës së Financës znj.Mimoza Dedja u shpreh: Në lidhje me përgatitjen e projekt-buxhetit për fazën e dytë, kjo është faza e dytë sepse faza e parë është dërguar në fillim të muajit Prill dmth është çertifikuar nga ZABGJ, tani në Korrik është faza e dytë. Të gjitha tabelat të cilat plotësohen nga ana e jonë me fondet e kërkuara janë të iniciuara nga vetë ZABGJ spese janë të miratuara nga vetë Ministria e Financave. Parashikimi për fondet nga ana e gjykatës është bërë në shpenzimet për pagat është marrë parasysh organika, e cila është e përbërë prej: konkretisht, Kryetari, 12 Gjyqtarë, 13 ndihmës ligjor, 15 sekretare gjyqësor, 1 Kancelar, 1 K/Sekretare, 1 K/D/Buxhetit, 2 Specialist IT dhe ZMP, 1 Specialist Administratë Protokoll, 1 Arkivist, 1 Shofer/mirëmbajtës, 1 Punonjës Sigurie, 1 Nepunës gjyqësor dhe 1 sanitare, gjithsej 52 punonjës. Për këta është planifikuar fondi për vitin e ardhshëm. Për gjyqtarët sipas ndryshimeve pagat janë ndryshuar dhe ligjit të ri që kanë filluar nga data 01 Janar 2019, ndërsa për punonjësit e administratës janë sipas VKM-së për pagat VKM nr.717.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Ideja është propozimet a janë parashikuar, vlerësuar nevojat e pritshme që do të ketë Gjykata.

K/Degës së Financës znj.Mimoza Dedja u shpreh: Kemi parashtruar një kërkesë për shtesë personeli prej 32 punonjes që përkojnë në shtesa në gjyqtarë, sekretarë gjyqësor ndihmës ligjor dhe punonjës administrate. Në lidhje me këtë është bërë tabela e pagave të sigurimeve shoqërore dhe ndërkohë janë marrë shpenzimet e tjera, 32 punonjësit konsistojnë 8 gjyqtarë

2 ndihmës ligjor, dhe 8 sekretare gjyqësore, kërkohet një specialist finance dhe një magazinier arkëtar sikurse e ka lanë detyrë KLSH, një mirëmbajtës për arsye se ndërtesa është e madhe dhe kërkon patjetër një mirëmbajtës në organikë për problemet ditore që lindin pasi deri tani ne nuk kemi në organikë mirëmbajtjes. Janë të domosdoshëm për lëvizjen e njerëzve të jashtëm në ambientet e gjykatës dhe ruajtjen e sigurinë në salla.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Ka ndonjë nevojë për ndonjë kërkesë të veçantë?

K/Degës së Financës znj. Mimoza Dedja u shpreh: Çështje të veçantë përveçse i theksoj faktit shtesës së organikës për arsye se është shumë e nevojshme. Në lidhje me këto janë kërkuar dhe shpenzimet operative, për të cilat ato i kanë koeficientët kufizues të përcaktuar nga EURALUS-i, numri i gjyqtarëve, sipërfaqja e godinës, numri i punonjësve aktual dhe plani i çelur nga buxheti i shtetit për vitin ushtrimor. Është parë në vijimësi se si janë harxhuar fondi i buxhetit letër, tonera, shpenzime të ndryshme dhe është bërë një mesatare e tre viteve është sikurse e thotë ligji financiar dhe kontrollin për arsye se nuk kemi as shtesë aktuale në personel dhe numri i gjykimeve pothuajse është i njëjtë, pra jemi në të njëjtat kushte si një vit më parë.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Materiali është i plotësuar për ta kaluar KLGJ?

K/Degës së Financës znj. Mimoza Dedja: Materiali është i plotë.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Ka ndonjë vërejtje ?

Kancelari i Gjykatës: Nuk kam.

Zëvendëskryetarja u shpreh se: Është fazë e kaluar nuk po shikoj se është ndonjë kërkesë për nëpunës gjyqësor. E shoh të nevojshme për nëpunësin gjyqësor, po shikoj që kemi vetëm një në organikë dhe nuk shoh që ka kërkesë tjetër. Duke patur parasysh se ka edhe njoftime elektronike të cilat bëhen në prani të tij, a mos ndoshta dhe numri i madh i institucioneve mbase është fazë e kaluar për ta diskutuar.

K/Degës së Financës znj. Mimoza Dedja: Çdo gjë behet me postë. Organika e re nga KLGJ nuk ka ardhur akoma për vitin 2019. Në organikë e kemi vetëm një nëpunës gjyqësor, në rolin e nëpunësit gjyqësor sot është punonjësi Mihal Balliu.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Ka nevojë për tu pasqyruar ajo që tha Zv/Kryetarja.

K/Degës së Financës znj.Mimoza Dedja: Po referuar kërkesave në vijimësi.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Ka të drejte se ato kërkesa ka patur si synim aty kur kemi pasur nevojë imediate dhe kemi patur nevojë imediate për sekretare gjyqësore. Jam fokusuar kryesisht tek sekretaret gjyqësore, ndërkohë që në këtë fazë ndryshon nevoja e gjykatës sepse jemi tashmë të plotësuar me sekretare gjyqësor, sepse tani çdo gjyqtar ka sekretare gjyqësore, mund të kemi nevojë për një apo dy sekretare regjistruar, pastaj do kemi nevojë shumë për shërbimet mbështetëse nëpunës gjyqësor apo punonjës sigurie të ofrojnë një nivel të duhur sigurie veçanërisht për sallat, megjithatë ne mund ta reflektojmë tek pjesa e nëpunësve gjyqësorë.

Zëvendëskryetarja u shpreh se: Nësë mund të ndërhyhet për ndonjë shtesë. Për të vijuar me ndonjë orientim

K/Degës së Financës znj.Mimoza Dedja: Orientimi është që shtesa nuk ka vetëm në raste emergjente, dhe më një argumentim, dmth pasi janë të njëjta shifra që janë dërguar janë kalkuluar në fazën e parë Ministria e Financave, mund të bëhet vetëm me zbritje në rast se do të zbresësh dicka është me arsyetim llogjik apo të shtosh dicka me arsyetim llogjik.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Të mbetet konsideratë këto që u trajtuan.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Miratojmë këtë dokument për në KLGJ

Zëvendëskryetarja: Po, dakort

Kancelari i Gjykatës: Dakort

Miratohet në unanimitet.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Të Vazhdojmë tek disiplina në punë nëse ka ndonjë propozim.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Unë kam menduar që të ketë një periudhë vlerësimi për ato aspekte ku është e nevojshme që të trajtohet në këtë këshill çështje që kanë të bëjnë me disiplinën në punë në vija të përgjithshme. Duke qënë se ligji i ri me krijimin e Këshillit ka bërë një lloj gërhëtimi të kompetencave të Kryetarit, Kancelarit të Këshillit në këtë funksion nëse të ketë një periudhë ku secili prej nesh mund të bëjë një vlerësim të përgjithshëm për të

gjithë situatën dhe vlerësimin e punës për performancën e gjykatës. Nëse ka ndonjë mendim për këtë çështje në këtë mbledhje mund ta mbajmë shënim.

Kancelari i Gjykatës: Unë mendoj që deri tani kemi bërë kartat dhe gjithë punonjësit e gjykatës nga sekretaret gjyqësore, punonjësit e tjerë qoftë dhe gjyqtarët, identifikohet qartë orari i ardhjes në punë. Në lidhje me performancën e sekretareve konstatohet se e mbajnë rregullisht pelerinat nëse ka për të shtuar diçka tjetër pastaj do ta diskutojmë.

Zëvendëskryetari u shpreh se: Pjesa e disiplinës në punë është një terminologjinë e gjërë që evidentoni probleme të përditshme të aspektit qoftë profesional qoftë dhe etik sa i përket etikës jo vetëm në ushtrim të funksioneve, rregullave në kryerjen e detyrës nga secili punonjës, por edhe në pjesën e rregullave të përgjithshme. Nuk jam në gjendje të evidentojë ndonjë problem konkret mbi këtë sferë, mendoj që Këshilli i Gjykatës mund të ndërhyjë vetëm me akte. Sa i përket mbledhjes së gjyqtaërëve për tu vënë pak në pozitë për të menduar krijuar një lloj mënyre organizimi për të stimular ardhjen e gjyqtarëve në mbledhjen e gjyqtarëve, ndërsa për pjesën tjetër të administratës nuk jam në gjendje të evidentojë ndonjë problem.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Çfarë mendon ti Zëvendëskryetare në lidhje me këtë evidentim?

Zëvendëskryetari: Ndoshta duke kjo është kompetencë e juaja, të karakterit qoftë të Kancelarit apo pjesës tjetër të administratës, paraprakisht tematikat e mbledhjes, duke evidentuar temat të aspektit profesional, juridik që tërheqin vëmendjen e trupës gjyqësore. Këto janë për momentin.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Thatë Stimulin.

Zëvendëskryetari: Thashë stimulin duke parë orarin dhe zhvillimin e këtyre mbledhjeve sepse pjesa më e madhe janë për gjykime orarin. Nuk kam gjë tjetër për të shtuar.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Keni ndonjë gjë tjetër tjetër për të diskutuar

Kancelari i Gjykatës: Jam dakort me ato që shprehu Zëvendëskryetarja, ideja, mirë do ishte që të mernin pjesë edhe ndihmësit edhe sekretaret gjyqësore në lidhje me problematikat gjatë proceseve pasi kanë problematika të ndryshme. Mire do ishte të mblidheshin të gjithë bashkë dhe të nxjerrin një konkluzion do të ishte më efiçente.

Zëvendëskryetari: Mendoj se i shërben qëllimit për të cilin organizohet mbledhja dhe e dyta ju mundëson juve në ushtrimin e funksioneve të Kryetrit në organizimin dhe drejtimin e mbledhjes.

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Tjetër për të diskutuar nëse ka

Kancelari i Gjykatës: Nuk ka.

Zëvendëskryetar znj.Lindita Sinanaj:Nëse keni ju për të evidentuar ndonjë problem që mund ta diskutojmë?

Kryetari i Këshillit të Gjykatës: Çështja e disiplinës pikërisht kur e nisa këtë diskutim kisha parasysh kalimin e kompetencave njëkohësisht kisha parasysh aspektin e detyrimit ligjor sa i përket çështjes së ngritur nga ana e juaj pjesëmarrjes në mbledhje, por në atë çfarë unë do të doja në fakt pavarësisht nga kompetencat duke qënë ky Këshill vlerëson në fund të fundit një vullnet të gjyqtarëve një vullnet po themi të KLGJ apo përfaqësimit të administratës. Është një bashkim i disa komponentëve ndoshta do të ishte e udhës e rendësishme për ta parë, në një kohë identifikimi vlerësimi i përgjithshëm pa iu referuar faktit sekretari gjyqësor se ka qënë korrekte, me etikën, sjelljen në respektimin e orarit, por çështja është po themi që ne të bëjmë një vlerësim të kemi një mbledhje të ardhëshme të bëjmë një vlerësim se ku mendojmë ku evidentojnë ne, ku has problem prezantimi i institucionit tonë ose mënyra e funksionimit të përgjithshëm të institucionit në raport me të tretët në raport me palët apo me qytetarët dhe sa është e mundur që këtu të shkëmbejmë ato ide apo mendime se pavarësisht kompetencave të ushtrimit të tyre të mund të kenë një ndikim të drejtëpërdrejtë dhe pozitiv sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me performancën e sekretareve gjyqësore apo të administratës në përgjithësi dhe nesë është e mundur për të qënë sadopak mbështetëse në të gjithë veprimtarinë e gjyqtarëve, për të përformuar sa më mirë që të jetë e mundur dhe në përputhje me ato standarte bashkëkohore dhe që ndahen ndoshta me gjykata të konsoliduara të Bashkimit Europian. Ky ishte mendimi im pa shkuar pastaj te një veprim konkret i cili do të jetë një produkt i një analize ku secili prej nesh për shkak të pozicionit apo të qënurit në këtë ambient mund të ndalojë dhe të zhvillojë një ide, apo zhvillojë një projekt mendim me të cilin mund ta ndanim dhe ta bënim objekt diskutimi. Sigurisht që unë për derisa e ngre këte çështje, vlerësoj se ka vend për të parë disa aspekte. Ka qënë pjesë e një diskutimi për çështjen e rregullores së brendshme, por duke menduar që rregullorja e brendshme duhet të ishte unike dhe kështu të paktën legjislacioni i ri shkoi drejt kësaj pike. Ne jemi në pritje KLGJ-së për të përgatitur një rregullore për gjithë gjyqtarët. Unë e di që është hartuar si draft, ndoshta është mbyllur si çështje drafti. Ndoshta kjo rregullore do na vinte shumë në ndihmë dhe këtu pastaj do të ishim thjesht në çështjen e zbatimit e cila do ezauronte dhe

mbulonte çështje të cilat kanë të bëjnë me disiplinën. Unë nuk doja që ky diskutim të zëvendësonte kompetencat e askujt po të të ishte një diskutim me kolegjal sa i përket kësaj çështje.

Ju falendëroj për mendimet e vyera që dhatë në këtë mbledhje.

Duke ju falenderuar!

Deklarohet e mbyllur mbledhja për sot.

ZËVËNDËSKRYETARI I GJYKATËS

Lindita SINANAJ

KRYETARI I KËSHILLIT TË GJYKATËS

Kastriot SELITA

KANCELARI I GJYKATËS

Leonard STRATAJ

SEKRETARE

Valbona ZENELAJ